



Shteti i Nju-Jorkut  
Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm

ERIC T. SCHNEIDERMAN  
PROKUROR I PËRGJITHSHËM



Departamenti i Arsimit të Shtetit të Nju-Jorkut  
Universiteti i Shtetit të Nju-Jorkut

MARYELLEN ELIA  
KOMISIONERE PËR ARSIMIN  
DREJTOR I UNIVERSITETIT TË SHETIT TË NJU-JORKUT

27 shkurt 2017

Masat e fundit në lidhje me emigrimin nga zyrtarët federalë kanë ngjallur frikë dhe konfuzion në të gjithë vendin. Rezidentët e shtetit të Nju-Jorkut, të cilëve janë zotuar t'u shërbejnë agjencitë tona si dhe Këshilli i Regjentëve i Shtetit të Nju-Jorkut, kanë komunikuar drejtpërdrejt me agjencitë tona rreth shqetësimeve dhe pyetjeve që kanë ngritur këto masa. Zyrat e Prokurorit të Përgjithshëm (Office of the Attorney General, "OAG") e Shtetit të Nju-Jorkut dhe Departamenti i Arsimit i Shtetit të Nju-Jorkut (State Education Department, "SED") shkruajnë sot për t'u konfirmuar studentëve, shkollave, familjeve dhe komuniteteve kudo në shtetin e Nju-Jorkut se shkollat tona do të mbeten streha të sigurta ku mund të studiojnë të gjithë studentët.

Sipas ligjit "Për arsimin" të Shtetit të Nju-Jorkut, fëmijët mbi pesë vjeç dhe nën njëzetënjë vjeç që nuk kanë marrë diplomë të shkollës së mesme kanë të drejtë të ndjekin shkollat shtetërore të distriktit në të cilin banojnë, pa paguar tarifë shkollimi. Gjithashtu, distriktet shkollore duhet të sigurohen që të gjithë studentët brenda moshës së arsimit të detyrueshëm të ndjekin studimet me kohë të plotë.<sup>1</sup> **Fëmijët e paregjistruar, si p.sh. fëmijët të cilët janë qytetarë të SH.B.A-ve, kanë të drejtë të ndjekin shkollat me kohë të plotë nëse përmbushin kërkesat e moshës dhe të rezidencës të përcaktuara me ligj.** Në fakt, disa dekada më parë Gjykata e Lartë e SHBA-së vendosi, në çështjen *Plyler v. Doe*, se distriktet shkollore nuk mund t'u mohojnë studentëve arsimimin publik falas për shkak të statusit të tyre si person i paregjistruar ose pa nënshtetësi, ose statusit të prindërve apo kujdestarëve të tyre.<sup>2</sup>

Përkatësisht, "OAG/SED" kanë theksuar këtë të drejtë thelbësore të studentëve të paregjistruar në udhëzimet për distriktet shkollore sipas së cilës, gjatë regjistrimit, shkollat nuk duhet të bëjnë pyetje në lidhje me statusin e emigrantit, të cilat mund të zbulojnë statusin e emigrantit të fëmijës, si p.sh të kërkojnë numrin e sigurimeve shoqërore.<sup>3</sup> Megjithëse distrikteve

---

<sup>1</sup> *Shih* Ligji "Për arsimin" §§ 3202(1), 3205.

<sup>2</sup> *Plyler v. Doe*, 457 U.S. 202 (1982); *shih gjithashtu "Appeal of Plata"*, 40 Përfaqësuesi i Departamentit të Arsimit 552, Vendimi nr. 14,555.

<sup>3</sup> *Shih, p.sh.*, Cosimo Tangorra, Jr., *Letra "Dear Colleague"*, Departamenti i Arsimit i Shtetit të Nju-Jorkut (10 shtator 2014), <http://www.p12.nysed.gov/sss/documents/EducationalServicesforRecentlyArrivedUnaccompaniedChildren.pdf>.

shkollore mund t'ju duhet të mbledhin të dhëna të caktuara në pajtueshmëri me ligjeve shtetërore dhe/ose federale, ne kemi këshilluar gjithashtu që ato duhet ta kryejnë këtë veprim pasi studenti të jetë regjistruar në shkollë, në mënyrë që të mos jepet joqëllimisht përshtypja se informacioni rreth statusit të emigrantit do të përdoret për të marrë vendime rreth regjistrimit.<sup>4</sup>

Kohët e fundit, agjencitë tona janë pyetur në mënyrë specifike rreth detyrimeve të distrikteve shkollore në lidhje me hetimet e mundshme nga përfaqësuesit e Agjencisë së Emigracionit dhe Doganave (Immigration and Customs Enforcement, "ICE") të SHBA-së, duke përfshirë kërkesa për të takuar apo intervistuar studentë ose për të pasur akses në të dhënat e studentëve. Siç jeni në dijeni, ka disa ligje që vendosin detyrime ligjore për distriktet shkollore sa i përket marrjes në pyetje të studentëve në shkolla nga autoritetet ligjzbatuese dhe konfidencialitetit të të dhënave të studentëve, duke përfshirë Ligjin e Gjykatës së Çështjeve Familjare të Nju-Jorkut (New York Family Court Act, "NYFCA") dhe Ligjin Federal të Drejtës së Familjeve për Arsimim dhe Privatësi (Family Education Rights and Privacy Act, "FERPA"). Shkelja e këtyre detyrimeve, qoftë edhe për të përmbushur një kërkesë të autoriteteve federale të emigrimit, mund t'i vërë distriktet e shkollave përpara përgjegjësisë. Për këtë arsye, agjencitë tona i inkurajojnë të gjithë punonjësit e distrikteve shkollore që të konsultohen me përgjegjësit dhe përfaqësuesit ligjorë të shkollave menjëherë pas marrjes së ndonjë kërkesë nga ana e një zyrtari federal të emigrimit. Përpara se t'u përgjigjen ndonjë kërkesë të tillë, punonjësit e distrikteve shkollore duhet të konsultohen me përgjegjësit e tyre dhe me përfaqësuesit ligjorë për të vendosur nëse respektimi i kësaj kërkesë do të shkaktonte shkeljen e ndonjë ligji me zbatim të gjerë, nga ana e distriktit shkollor.

*Kërkesat për të takuar ose intervistuar studentët. **Prej kohësh qëndrimi i "SED" nuk lejon që zyrtarët ligjzbatues t'i shkëpusin studentët nga ambientet e shkollës apo t'i marrin ata në pyetje pa pëlqimin e prindërve apo të një personi në marrëdhënie prindërore,*** përveçse në situata shumë të kufizuara (*p.sh.*, kur zyrtarët ligjzbatues kanë një mandat të vlefshëm ose kur në ambientet e shkollës është kryer një krim).<sup>5</sup> Ne i inkurajojmë nëpunësit e shkollave që të bashkëpunojnë me autoritetet ligjzbatuese brenda kufijve të ligjit dhe politikave lokale të shkollave. Ne rekomandojmë me bindje se, në rast se zyrtarë të "ICE" apo zyrtarë të

---

<sup>4</sup> Duke iu referuar në mënyrë të veçantë identifikimit të sigurimeve shoqërore, "SED" nuk u kërkon distrikteve të mbledhin kartat apo numrat e sigurimeve shoqërore të studentëve për asnjë qëllim dhe në asnjë moment, qoftë përpara apo pas regjistrimit të tyre.

<sup>5</sup> *Shih p.sh.* N.Y.S.E.D. Opinioni i këshilltarit ligjor 91 (17 qershor 1959) ("asnjë zyrtar nuk mund të shkëpusë një fëmijë nga godina e shkollës ndërkohë që fëmija është nën mbikëqyrjen e duhur, pa leje nga prindi i fëmijës për marrje në pyetje"); *shih gjithashtu* N.Y.S.E.D. Opinioni i këshilltarit ligjor 148 (23 shkurt 1965) ("Në veçanti, shkolla nuk mund të përdorë kujdestarinë e nxënësve për qëllimin e autorizimit të zyrtarëve ligjzbatues apo të palëve të treta për të marrë në pyetje nxënësit apo për t'i larguar këta të fundit nga godina e shkollës për çfarëdolloj arsyeje".) Ky qëndrim bazohet në ligje të ndryshme që përfshijnë, *midis të tjerash*, "NYFCA", sipas të cilit oficerët e policisë duhet të bëjnë çdo përpjekje të mundshme për të kontaktuar menjëherë prindin e fëmijës apo personat përgjegjës për kujdesin e fëmijës kur një fëmijë nën moshën 16 vjeç merret nën kujdestarinë e autoriteteve ligjzbatuese, si dhe thekson më tej se fëmija nuk mund të merret në pyetje derisa prindi apo kujdestari i tij/i saj, nëse është i pranishëm, të jetë këshilluar për të drejtat e fëmijës dhe t'i jetë dhënë mundësia për të marrë pjesë në marrjen në pyetje. *Shih Ligji i Gjykatës së Çështjeve Familjare të Nju-Jorkut § 305.2; Çështja e Jimmy D.*, 15 N.J.3d 417 (2010).

tjerë federalë të emigrimit paraqiten në shkollë dhe kërkojnë të takojnë studentët (për intervista dhe/ose marrje në pyetje), distrikti shkollor duhet të këshillojë të gjithë stafin që të kontaktojë menjëherë përgjegjësën dhe përfaqësuesin ligjor të distriktit shkollor për udhëzime, veçanërisht në lidhje me detyrimet e tij sipas ligjit "Për arsimin", *Plyler*, si dhe "NYFCA" përpara se të autorizojnë takimin me një student.

*Kërkesat për akses në të dhënat e studentëve.* Në mënyrë të ngjashme, agjencitë tona këshillojnë që, pas marrjes së një kërkesë nga zyrtarët e emigracionit për akses në të dhënat e shkollimit të studentëve, distriktet shkollore duhet të konsultohen menjëherë me përfaqësuesit e tyre ligjorë, duke qenë se pajtueshmëria me këtë kërkesë nëpërmjet zbulimit të informacionit mund të përbëjë shkelje të "FERPA".<sup>6</sup> Në përgjithësi, "FERPA" ndalon dhënien e informacioneve identifikuese personale (Personally Identifiable Information, "PII"), të cilat gjenden në regjistrat shkollorë të studentëve, nga distriktet shkollore që marrin fonde federale, pa pëlqimin e prindit apo studentit të zgjedhur. "FERPA" e lejon zbulimin e këtij informacioni pa pëlqim vetëm nëse ai përmbush disa kushte të kufizuara të përcaktuara në rregulloret e zbatimit të ligjit. Këto kushte të kufizuara përfshijnë kërkesat e bëra nga individë të veçantë të qeverisë federale.<sup>7</sup> **Megjithatë, një kërkesë nga zyrtarët e "ICE" ose zyrtarë të tjerë federalë për akses në "PII" e studentëve nga regjistrat shkollorë nuk duket se përmbush ndonjë nga përjashtimet e "FERPA" nga rregulli i përgjithshëm që prindi apo studenti i zgjedhur duhet të japë pëlqimin për zbulimin e informacionit për palët e treta.**<sup>8</sup>

Gjithashtu, Zyra e Politikës së Arsimit P-12 e "SED" po jep sot udhëzime për shkollat dhe distriktet në lidhje me Ligjin për Dinjitet për të Gjithë Studentët (Dignity for All Students Act, "DASA"), nisur nga raportimet për incidente ngacmimesh në shkolla në mbarë vendin gjatë javëve të fundit. Ky udhëzim do të vihet në dispozicion këtu: <http://www.p12.nysed.gov/dignityact/documents/dasa-guidance.pdf>.

Në një kohë kur po ngrihen shumë pyetje rreth masave që do të ndërmerren nga qeveria federale në lidhje me emigrimin, është shumë e rëndësishme që ne, si edukatorë dhe zyrtarë shtetërorë, t'u kujtojmë komuniteteve të shkollave tona rëndësinë e përfshirjes dhe të drejtën e çdo studenti për arsimim, pa pasur frikë nga ndëshkimi thjesht duke qenë në shkollë. Klasat tona duhet të mbeten streha të sigurta për të gjithë fëmijët. Ju falënderojmë sërish për gjithë punën që bëni në mbështetje të studentëve, familjeve dhe komuniteteve tona.

Me respekt,

---

<sup>6</sup> *Shih* 20 U.S.C. § 1232g.

<sup>7</sup> Në përputhje me 34 C.F.R. §99.31(a)(3), informacioni mund t'u jepet, duke iu nënshtruar kërkesave të 34 C.F.R. §99.35, përfaqësuesve të autorizuar të Kontrollorit të Përgjithshëm të SHBA-së, Prokurorit të Përgjithshëm të SHBA-së, Sekretarit të Departamentit të Arsimit të SHBA-së ose autoriteteve shtetërore dhe lokale të arsimit.

<sup>8</sup> *Shih* 34 C.F.R. § 99.31.



MaryEllen Elia  
Komisionere për Arsimin



Eric T. Schneiderman  
Prokuror i Përgjithshëm